

Zgjedhjet Elektorale

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Respekti për Ligjin dhe Rendin, Drejtësia, Liria, Përgjegjësia, Barazia, Qytetaria aktive dhe e përgjegjshme, Solidariteti, Mirëkuptimi, Toleranca, Pranimi.

Qëllimet

Pedagogjike: Zhvillimi i komunikimit ndërpersonal, mirëkuptimit, pranimit dhe tolerancës në proceset e diskutimeve. Njohja e rëndësisë së kompromisit në mbështetjen dhe praktikat efektive dhe të përgjegjshme të demokracisë.

Praktike: Përgatitja e një programi elektorale dhe zgjedhja e presidentit të klasës.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 12 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

60 deri 90 minuta

Materialet

Letër dhe stilolaps


Përmbledhje

Mësuesi/ja duhet të ndajë klasën në tre grupe. Çdo grup zhvillon programin e vet elektorale për qeverinë e klasës. Çdo grup emëron kandidatin për president dhe zëdhënësin e tij.

Çdo zëdhënës i prezanton klasës kandidatin e grupit përkatës për një kohë prej 5 minutash. Më pas, secili kandidat i paraqet klasës programin elektorale të grupit të tij për rreth 5 minuta.

Të gjithë nxënësit votojnë duke u bazuar në politikat e kandidatëve. Në fazën e parë të zgjedhjeve, zgjidhen dy ose tre kandidatët më shumë të votuar dhe më pas zhvillohet një garë midis tyre nëpërmjet një fjalimi final të fushatës elektorale.

Më pas zhvillohen zgjedhjet përfundimtare. Kandidati me më shumë vota zgjidhet president i klasës.



Zgjedhjet Elektorale

Fleta e Mësuesit

Shënime

Secili grup mund të paraqesë pikat kryesore të programit elektor në një poster për t'u ekspozuar në një hapësirë të përbashkët të shkollës ose t'i publikojë në gazetën e shkollës.

Diskutimi

Pas zgjedhjeve, duhet të bëhet një analizë e përgjithshme e aktivitetit dhe duhet të nxitet diskutimi midis nxënësve.

Çfarë ndjetë kur kishit për të përgatitur programin elektor për klasën?

Çfarë ndjetë në lidhje me mënyrën se si u zhvilluan zgjedhjet?


Çfarë kriteresh morët në konsideratë për të përzgjedhur kandidatin? Sa i rëndësishëm ishte fjalimi përfundimtar midis kandidatëve më të votuar?

Cili duhet të jetë profili i presidentit?

Çfarë parimesh duhet të ndiqen për të siguruar një proces elektor të suksesshëm?

Cili është impresioni juaj rreth procesit elektor në Shqipëri?

Çfarë rëndësie ka procesi elektor për ju vetë, për familjen tuaj dhe komunitetin tuaj?



(Përshtatur nga Learning to Live Together, UNESCO, 1998)